



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167660

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05947605

KPPP.nr.1213/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka për Biznes” me seli në Prishtinë rr. “Ukshin Hoti” nr.128 , kundër debitorëve, 1. “Jafax” PVC L.L.C., me numër të biznesit 811579658 me adresë në magjistralja Prishtinë- Ferizaj, përfaqësuar nga A.M. me numër personal me adresë banimi në fshatin, Komuna e Vitisë, 2. A.M. me numër personal ..., me adresë banimi në fshatin ... Komuna e Vitisë dhe 3. A.M. me numër personal ... me adresë banimi në fshatin ... Komuna e Vitisë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të dytë, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 486/23 të datës 13.07.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli, me seli të zyrës në Ferizaj, me datë 17.07.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit A.M., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr. 486/23 i datës 13.07.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Banka për Biznes”, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 486/23 të datës 13.07.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartuese, Kontratë mbi Kolateralin (pengun e luajtshëm) nr.K0423/3, e cila marrëveshje del nga Kontrata për Kredi të Biznesit nr.K0423/3 e datës 17.01.2023 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20230119-780, duke detyruar debitorët që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 24,129.02€ (njëzet e katër mijë e njëqind e njëzet e nëntë euro e dy cent) përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve, duke kalkuluar edhe interesin e rregullt dhe kamatëvonesën deri në pagesën definitive, apo shitjes, dorëzimit dhe lirimi nga sendet dhe njerëzit të pasurisë së paluajtshme sipas kontratës së hipotekës, bashkë me shpenzimet e procedurës.

Debitorët brenda afatit ligjor, kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor me arsyetimin se kërkesa është jo ligjore dhe në kundërshtim me gjendjen faktike dhe reale bazuar në ligjet në fuqi. Ka shtuar se kreditori me kohë është njoftuar për vështirësitë e debitorit në përmbushjen e kësteve të kredisë, mirëpo i njëjti fare nuk e ka trajtuar gjendjen e vështirësuar të debitorëve. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe urdhri për përmbartim të hedhet poshtë.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur kreditori, i cili ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve duke shtuar se nuk janë përmbushur asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së për paraqitjen e prapësimit dhe rrjedhimisht i njëjti duhet të refuzohet si i pabazuar. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, rekomandimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22, par. 1.7 përcaktohet se *“1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”* kurse me nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*.

Gjykata duke vlerësuar Kontratën mbi Kolateralin (pengun e luajtshëm) nr.K0423/3, gjeti se e njëjta nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht në shkresa të lëndës nuk është deponuar në origjinal apo kopje të noterizuar, andaj gjykata vlerëson se urdhri i lejuar mbi bazën e kësaj marrëveshje nuk është në përputhje me nenin 38 par. 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *1. Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet,*

si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.”.

Në këtë drejtim, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”*, gjykata erdhi në përfundim se urdhri për lejimin e përmbarimit duhet të anulohet, pasi që dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, nuk është titull ekzekutiv.

Andaj, gjykata aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit A.M. dhe shfuqizoi Urdhrin Përmbarimor P.nr. 486/23 të datës 13.07.2023 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Bardh B. Tasholli përkitazi me dokumentin përmbarimorë Kontratë mbi Kolateralin (pengun e luajtshëm) nr.K0423/3, e cila marrëveshje del nga Kontrata për Kredi të Biznesit nr.K0423/3 e datës 17.01.2023 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20230119-780, pasi që Kontrata mbi Kolateralin (pengun e luajtshëm) nr.K0423/3, nuk përbën titull ekzekutiv, pasi që nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1213/23, datë 17.07.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.